



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d e Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisjen lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor, 2008), të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 10.11.2021, merr këtë

**VENDIM PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E VENDIMIT PËR NDARJEN
E MJETEVE, SI NDIHMË KOMUNËS SË PRESHEVËS ME RASTIN E
FATKEQËSIVE NATYRORE**

I.

MIRATOHET Vendimi për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit për ndarjen e mjeteve, si ndihmë Komunës së Preshevës me rastin e fatkeqësive natyrore, nr. 01-120/03-112390/21, dt. 16.06.2021

II.

Shuma e mjeteve të ndara, sipas pikës I të këtij vendimi, është 50,000.00 € dhe merren nga kategoria e subvencioneve nga Drejtoria e Administratës.

III.

Sipas pikës I të këtij vendimi, plotësimi dhe ndryshimi i vendimit të mëhershëm bëhet për shkak të pengesave në realizimin e pagesës. Andaj, propozohet që pagesa për Komunën e Preshevës të bëhet përmes llogarisë së Unionit të Bashkive Shqiptare në Rajon (UBSHR).

IV.

Mjetet e cekura sipas pikës II të këtij vendimi, do të derdhen në Raiffeisen Bank, SHA, Tiranë, emri i llogarisë bankare: Shoqata UBShR L92006451C, numri i llogarisë së Bankës, 0021417457, SWIFT: SGSBALTX, BIC: AL0720211006000000021417457, Adresa: BVL ZOGI I 1, PLL 7 katësh, kati 5, Tiranë, Albania.

V.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Financave.

VI.

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-451/02-245484/21, më 12.11.2021

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta

